



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 10933 prot.

Shkodër, më 30.5. 2025

**VENDIM**

**Nr. 31, datë 29.05.2025**

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT “PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E  
ZJARREVE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR NË BASHKINË SHKODËR PËR VITIN  
2025”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.05.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në nenin 27 pika 5, nenin 54 të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; neni 30 pika 4, geramat ‘b’ dhe ‘c’ të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”; Ligjit nr. 45/2019 “ Për mbrojtjen civile”; Ligjit Nr. 9693, datë 19.3.2007: “Për fondin kulllosor”, të ndryshuar; VKM-në nr. 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”; VKM-në nr. 433 datë 08.06.2016 “ Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike , sipas listës së inventarëve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, të ndryshuar; VKM-në nr. 59, datë 26.01.2022 “ Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe sipërfaqes së ekosistemeve natyrore park kombëtar ( kategoria II) të zonave të mbrojtura”; VKM-në nr. 60, datë 26.01.2022 “ Shpallja e ekosistemeve natyrore rezervat natyror i menaxhur /Park Natyror (kategoria IV) , si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie”, i ndryshuar, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë planin “Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kulllosor në Bashkinë Shkodër për vitin 2025”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 35 vota

|                  |            |
|------------------|------------|
| Vota Pro         | 35         |
| Vota Kundër      | 0          |
| Vota Abstenim    | 0          |
| Zbardhur me datë | 30.05.2025 |

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**



**KRYETAR**

**Oltion LULI**

